



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 94, datë 10.04.2020

**PËR MIRATIMIN E HEQJES DORË NGA KANDIDIMI PËR
PROKUROR NË PROKURORINË E POSAÇME TË ZNJ. ANITA JELLA**

Mbështetur në nenin 148/dh të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 94 të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në nenin 189/3 të Ligjit 115 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe vendimin nr. 137 datë 16.07.2019 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë “Për miratimin e listës me renditjen e kandidatëve për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme”, i ndryshuar, pasi u njoh me kërkesën e datës 26.03.2020 për heqjen dorë të znj. Anita Jella nga kandidimi për prokuror në Prokurorinë e Posaçme dhe relacionin përkatës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Të miratojë heqjen dorë nga kandidimi për tu emëruar prokuror në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar të znj. Anita Jella.
2. Të deklarojë të përfunduar procedurën e ngritjes në detyrë për znj. Anita Jella.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

**KRYETARI
GENT IBRAHIMI**

**ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA**

**ANËTAR
KOSTAQ BELURI**

**ANËTAR
BUJAR SHESHI**

**ANËTAR
NURIHAN SEITI**

**ANËTAR
SANDËR BECI**

**ANËTAR
VATË STAKA**

**ANËTAR
TARTAR BAZAJ**

**ANËTAR
ESMERALDA KESHI**

